



**NATIONAL  
ASSOCIATION OF  
REALTORS®**  
GLOBAL



Str. Elbasanit, Apt. Building 10/1, 1<sup>st</sup> Floor, Unit 3  
Administrative Unit 2, Tirana, Albania, Europe  
Phone +355 69 40 40 150 Email [info@narea.al](mailto:info@narea.al)  
[www.narea.al](http://www.narea.al)

**Nr. Prot. 501**

**Datë 30 /05/2023**

**NGA:** “Shoqata Kombëtare e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme të Shqipërisë” (**NAREA**), e themeluar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë **Nr. 5227**, datë **22/01/2016**, me **NUIS M12222452E**, me seli në adresën Rruga e Elbasanit, Pallati 10/1, Kati 1, Apartamenti 3, Njësia Administrative 2, Tiranë, e përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Z. Reinaldo Pipiria

**DREJTUAR:** Mediave të shkruara dhe audiovizive

**LËNDA:** Informacion mbi nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale të bashkëpunimit dhe anëtarësimit ndërmjet National Albanian Real Estate Association (**NAREA**) dhe National Association of Realtors® (**NAR**, USA nivel federal), Orlando Regional Realtor® Association (**ORRA**, USA nivel shteti) si dhe MIAMI Association of Realtors® (**MIAMI REALTORS®**, USA nivel shteti)

Të nderuar kolegë,

Kemi kënaqësinë t’ju informojmë se në datë 7 Maj 2023, **NAREA** dhe National Association of Realtors (**NAR**) nënshkruan marrëveshjen bilaterale të Bashkëpunimit dhe të Anëtarësimit në Washington D.C.. Mes të pranishmëve në këtë ceremoni ishte edhe Shkëlqesia e saj Znj. Floreta LULI FABER, Ambasadore e Republikës së Shqipërisë në Washington D.C.

Themeluar në 1908, **NAR** është organizata e biznesit më e madhe në SHBA për nga anëtarësia, me mbi 1.5 Milionë Anëtarë përfshirë Institutet e saj të Kërkimit, Shoqëritë dhe Këshillat. **NAR** është e përfshirë në të gjitha aspektet e pasurive të paluajtshme në vend, si për ato rezidenciale dhe komerciale. Sektori i Real Estate në SHBA, kontribuon mesatarisht me 4.1 trilion USD, duke mbajtur peshën e 16.3% të PBB (të dhëna për vitin 2022, **NAR**)<sup>iii</sup>. Të paktën 90% e transaksioneve me Pasuritë e Paluajtshme kryhen nëpërmjet Ndërmjetësve, me një vlerë të përmirësuar deri +30%.

Kjo marrëveshje bilaterale përbën një mundësi të artë për sektorin e pasurive të paluajtshme në Shqipëri për të përfituar nga eksperiencia e gjatë dhe e suksesshme e **NAR** si në terma të ofertave formative për agentët dhe brokerat tanë, por, dhe për më tepër, si një markë cilësie në tërheqjen e investimeve të huaja në këtë sektor në Shqipëri.

Sot, **NAREA** e gjen veten në pozitën e një aktori lider në sektorin e pasurive të paluajtshme në Shqipëri, duke qenë e vetmja organizatë e tillë në vend, dhe më e madhja ndër organizimet profesionale dhe ato të sipërmarrjes, me mbi 500 anëtarë, por gjithashtu edhe në rolin e promovuesit të praktikave të biznesit bazuar mbi etikën dhe rregullimin ligjor në fuqi.

Në kuadër të këtij partneriteti strategjik dhe Akademisë së **NAR**, **NAREA** synon zgjerimin e veprimtarive të saj jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Përmes Akademisë së **NAR**, **NAREA** sjell ofertën më të mirë të njohur ndërkombëtarisht në fushën edukimit në real estate.

Për qëllime të kësaj akademie dhe në bashkëpunim me Institutet në varësi të **NAR**, të tilla si Institutin e Biznesit të Pasurive të Paluajtshme (**REBI**) dhe Qendrën e Zhvillimit të Ndërmjetësuesve (**CRD**), **NAREA** do të ofrojë **20 Tituj dhe Certifikime Profesionale Ndërkombëtare** brenda një kuadri prej mbi **100 trajnimeve**, të cilat do të janë të vlefshme për Ndërmjetësit e Pasurive të Paluajtshme në Shqipëri, dhe më gjerë në rajon, duke i dhënë udhë kështu edukimit të vazhdueshëm të ndërmjetësve dhe përmirësimit të ofrimit të shërbimeve në ndërmjetësim.

Në të njëjtën kohë **NAREA** është duke e shtrirë fushën e saj të bashkëpunimit jo vetëm në nivel federal me **NAR**, por gjithashtu në nivel shteti përmes nënshkrimit të marrëveshjeve me **Orlando Regional Realtors® Association (ORRA)** dhe **Miami Association of Realtors®**, përmes së cilave **NAREA** do jetë në gjendje të mundësojë platforma dhe oportunitete B2B që do të rezultojnë në rritjen e IHD-ve në Shqipëri.

Duke ju siguruar për vendosmërinë tonë për të vazhduar këtë udhëtim me të njëjtin pasion dhe përkushtim,

Me Respekt,

**Shoqata Kombëtare e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme të Shqipërisë (NAREA)**

Drejtori Ekzekutiv



**Z. Reinaldo Pipiria**

Disa momente nga Ceremonia e Nënshkrimit të Marrëveshjes Bilaterale të Bashkëpunimit dhe Anëtarësimit ndërmjet **NAREA** dhe **NAR** në Washington D.C.:



---

<sup>i</sup> <https://www.nar.realtor/research-and-statistics/quick-real-estate-statistics>

<sup>ii</sup> [https://cdn.nar.realtor/sites/default/files/documents/2023-state-by-state-economic-impact-of-real-estate-activity-report-us-05-01-2023.pdf?\\_gl=1\\*1g3zfq\\*\\_gcl\\_au\\*MjcwMjA5NDE2LjE2NzkwMDU4NjI](https://cdn.nar.realtor/sites/default/files/documents/2023-state-by-state-economic-impact-of-real-estate-activity-report-us-05-01-2023.pdf?_gl=1*1g3zfq*_gcl_au*MjcwMjA5NDE2LjE2NzkwMDU4NjI).